



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

24 shtator 2014

THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIM

(Afirmimi i të drejtave të komuniteteve)

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me qëllim të avancimit të qeverisjes lokale fton të gjitha organizatat joqeveritare që veprojnë në Republikën e Kosovës, të aplikojnë për realizimin e projekteve të vogla në fushën e qeverisjes lokale. Tashmë komunat e Republikës së Kosovës kanë një bazë të qëndrueshme të infrastrukturës ligjore, përmes të cilës OJQ-të mund të japin kontributin e tyre në avancimin e mëtutjeshëm të modaliteteve qeverisëse, në të mirë të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve si dhe afirmimit të të drejtave të komuniteteve për të siguruar respektim të plotë të kornizës ligjore pa dallim përkatësi etnike, gjinore etj. MAPL-ja vlerëson se përmes ndarjes së këtyre granateve, t'u mundësojë përfaqësuesve të komunave të jenë sa më afër ideve novatore të shoqërisë civile, të cilat, gjithnjë në harmoni me legjislacionin gjegjës, sugjerojnë dhe praktikojnë ide më pragmatike në të mirë të avancimit të qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Projekti duhet të realizohet gjatë vitit fiskal 2014.

Kërkesat (Projekt-propozimet) duhet të përmbajnë:

1. Projekt-propozimin;
2. Buxhetin e detalizuar, si dhe arsyetimin e linjave buxhetore;
3. Afatin (dinamik) kohor për implementim;
4. Përshkrimin e detalizuar të kapaciteteve menaxhuese të organizatës (*personeli, pajisjet dhe aftësitë për të menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete, etj*);
5. Një kopje që dokumenton regjistrimin e OJQ-së/ve, konform ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës;
7. Referencat për punë të ngjashme;

8. Aplikantët duhet të kenë xhirollogari në një të njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Të gjithë të interesuarit për aplikim mund të marrin informata në Departamentin për Transparencë dhe Përformancë Komunale në MAPL, përmes tel: 038 200 35 509, ose në uebfaqen e MAPL-së: <http://www.mapl-ks.org>

Propozimet e kompletuara e të mbyllura në zarf mund të dorëzohen në zyrat e Departamentit të Performancës dhe Transparencës Komunale në MAPL ish-“Rilindja”, kati X. Data e fundit për aplikim është deri më 03 tetor 2014, në ora 14:00. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Sqarim: Projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ e komuniteteve do të trajtohen me prioritet.